



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Komuna e Drenasit  
611-22-1597-1-2-1/C529



## KONTRATË FURNIZIMI

KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

TITULLI: **Blerja e kontenjereve per mbeturina**

Numri identifikues: 611-22-014-121 Përgatitur në Drenas, 27.04.2022 Nr. i arkivit:02-400-18333

### PALËT NË MARRËVESHJE

KOMUNA E DRENASIT - DRENAS, përfaqësuar nga GEZIM HAJDINI, Zyrtar i Prokurimit ( më tutje "Punëdhënës")

" BK Cosulting "SH.P.K., , përfaqësuar nga Besnik Krasniqi , (më tutje "Kontraktues")

#### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim: **Blerja e kontenjereve per mbeturina**

1.2 Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë: tri dite nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

1.3 2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: **Blerja e kontenjereve per mbeturina** 3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

#### Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total I furnizimeve duhet të jetë: **19,950.00**( Nentembdhjetemije e Nenteqind e Pesedhete euro )

4.2 Afati per furnizim eshte 60 dite .

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

#### Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

0.5 Kudo që ne konstatë parashikohet shpesh e ndonjë njoftim, pëlqim, miratim, certifikatë, ose vendim, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shihen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

#### PIESË II E KONTRATËS

28.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbytëse nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

28.2 Nderprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përbushjen duhet të pushohet së ekzistuar menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

28.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

28.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rezhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

28.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

28.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

## **Neni 29 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit**

29.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumën që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

29.2 Nderprerja do te benei pa paragjykim per noonje te drejte apo autoritet tjetër sipas kontrates se Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

29.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 29.1 . Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

### **Neni 30 Forca madhore**

30.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

30.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtërngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

30.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 16 dhe 28. Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 20.5 dhe 29, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

30.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues

30.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 30.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

### **Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

31.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes

### **Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

### **PIESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Neni	<b>Blerja e kontenjereve per mbeturina</b>
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

	2.2	Gjuna e përorur do të jetë (DHPE)
Siguria e ekzekutimit	9.1	10 % e vlerës së kontratës, validiteti 90 dite
Sigurimi	10.1	Nuk kërkohej.
Programi i ekzekutimit	11.1	1 ditë pas nënshkrimit të kontratës
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	Të gjitha duhet të paguhet nga Kontraktuesi
Patentat dhe licencat	13.1	Sipas specifikimit të përshkruar në Neni 13 i KPKJ
Cilësia e furnizimeve	18.1	Furnizimet duhet të jenë konform specifikime të kërkuara duke përfshirë Furnizimet duhet të kryhen brenda afatit të paraqitur në ofertë.
Inspektimi dhe testimi	19.1	Inspektimin e kryen DHPE sa herë që ka nevojë me shpenzime të kontraktuesit.
Pagesa	20.1	Autoriteti kontraktues do t'i paguajë Kontraktuesit shumën e obligimit brenda [30] ditësh pas datës në të cilën është regjistruar pagesa e pranueshme, Menaxhimi e kësaj kontrate e Kryen Menaxheri i Projektit i caktuar me një Vendim nga Kryetari i Komunës , i cili e harton një Plan të Menaxhimit të kontratës konform Neni 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 Afati i furnizimeve duhet të kryhet sipas afatit të prezentuar nga Ofertuesi. Në komisione të pranimit nuk duhet të caktohen personat që kanë marrë pjesë në hartimin e specifikimeve dhe ata të cilët kanë marrë pjesë në vlerësimin e ofertave.
Dorëzimi	21.2	<b>Blerja e kontejnereve për mbeturina</b> dorëzohet në Objektet e Institucioneve K.K Drenas përkatësisht tek Menaxheri i Projektit dhe Komisioni pranues.
Obligimet e garancionit pas pranimit të paisjeve	24.1	Nuk kërkohej
Monitorimi	24.2	Menaxheri i projektit duhet të jetë pjesë e Planit të Menaxhimit të kontratës dhe obligohet që monitorimin e kontratës në aspektin Ligjor ta kryej sa herë që kërkohej ta kryej konform neneve të kontratës dhe ligjeve në fuqi dhe duhet të bindet se kontrata implementohet ashtu edhe si është hartuar. Poshtu merrë përsipër të përballet (së bashku me Avokatin komunal) me pengesat eventuale dhe mbrojtjen e kontratës dhe interesave të Komunës para institucioneve tjera.
Shërbimet pas shitjes	25.1	N/A
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Mundesisht në mes të dy palëve..
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet (Gjykata Ekonomike e Qarkut - Prishtinë) në pajtim me ligjin në Kosovë.
Pagesat	33.1	Të gjitha pagesat bëhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtarja për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës për punët e kryera do të caktohet nga Menaxheri i Projektit.
Dorëzimi i dokumentave	33.2	Të gjitha pagesat mund të kryhen nga Zyrtarja për pagesë vetëm nëse janë ofruar dokumentet si: Plani i Menaxhimit, aktvendimet, procesverbalet, raportet, situacionet për punët e kryera, faturat, atestimi, shkresat, fletët e ditarit të punës, sigurimet etj.





Arkimi i dokumentave	33.3	Zyrtarja per pagese dhe arkivim te lendeve, obligon qe te gjtha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë. Një kopje e faturës, raportit të pranimit dhe kontratës pas përfundimit të projektit duhet të dorëzohen tek Zyrtarja për rexhistrimin e pasurisë.
Hyrja në fuqi	33.4	Kontrata hynë në fuqi menjëher pas nënshkrimit të palëve. Kontrata hartohet në 2 kopje origjinale.

Kësaj kontrate i bashkangjitet:

- a. Oferta financiare e Tenderuesit , b) Afati i furnizimit

Për Autoritetin Kontraktues


Për Ofruesin e Furnizimeve

Emri:	GEZIM HAJDINI	Emri:	BESNIK KRASNIQI
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	27.04.2022	Data:	27.04.2022
Vula:		Vula:	

Paramasa dhe Parallojaria për blerjen e Kontejnerve të tipit Abrolli me kapacitet 36m³

Nr. tender	Lloji i Furnizimit	Mjesia	Sasia	Çmimi njësi (Euro)	Çmimi total (Euro)
1	<p>Blerja, Furnizimi, Transporti dhe shërbimi i kontejnerve të tipit Abrolli me keto karakteristika:</p> <p>Kontejner me rrotullim sipas DIN 30722-1, standardi S 88 s</p> <p>Permasat e brendshme: përfaqësimi 6,5 x 2,4 x 2,35 metra (të gjitha dimensionet janë permasa të përafërta)</p> <p>Kapaciteti neto: përfaqësimi 36 m³</p> <p>Bojë: RAL 6018 (verdhë-jeshile)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajisje montimi për sistemet e grepave sipas DIN 30722-1 (15000 kg) me rula të jashtëm të pasme dhe nënkornize prej çeliku të jashtëm INP 180 që mund të lubrifikohen dhe vendësohen Klapa montimi Ø 50 mm, kartesia e grepit 1,570 mm , prej 4 detyrimeve mm St 37.2 (S235JR)</li> <li>• Muret antësore prej 3 mm St 37.2 (S235JR)</li> <li>• Hapësira e kornizës 750 mm</li> <li>• Profili i kornizës U 80 x 50 mm</li> <li>• Profili i fundor: i bërë nga tubi i qendrueshëm i rrumbullakët Ø 90 mm</li> <li>• Dera me dy krahë me Bllokuesi i derës holandeze dhe kyçi qendror i sigurisë antësore sipas UVV</li> <li>• Kyçja e derës me ndihmes për hapjen e derës së kontejnerit,</li> <li>• Pëlhurë gomë e rrumbullakët dhe grepa rrethë,</li> <li>• Shtyllë vertikale të galvanizuar sipas frontit UVV,</li> <li>• Kontejner me astar një here nga brenda, dy here në pjesën e jashtme dhe dy here të tjerë me një ngjyrë nga jashtë,</li> <li>• Ngjithëse UVV me udhëzime sigurie ,</li> <li>• kontejner i testuar dhe miratuar në përputhje me Rregullën 114-010 të DGUV (në parë BGR 186)</li> </ul>		2	9.975,00	19.950,00
		copy			



		Gjithësejft	19,950.00
--	---	-------------	-----------

**Vërejtje:** Në çmimin e dhënë të llogaritet sigurimi, transporti dhe shkatërimi i kontejnerve në lokacionin e caktuar nga investitori

Kohezgjatja e liferimit të këtyre pajisjeve nuk mund të jetë më tepër se 60 ditë punë, pas nënshkrimit të kontratës

Garancioni të jetë minimum: 12 muaj

Në dosjen e tenderit të dorëzohen edhe këto dokumente:

Çertifikata e ISO standardeve, (nga prodhuesi), që duhet të ofertojësi të bashkangjës në dosje

Çertifikata e kualitetit që i plotëson standardet teknike (nga prodhuesi)

(Dëshmia mbi Testin aktual në bazë të Euro Normave nga prodhuesi)

Kontejneret duhet të jenë përfaqësues të ngjajshëm si në foto të kësaj parametere

Përgaditi: Afrim Prokshi

